



THIRRJE PËR APLIKIM ME PROJEKT-PROPOZIME PËR 2025

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall thirrjen për aplikim për mbështetje financiare të projekt-propozimeve për vitin 2025. Për të gjitha **Organizatet Jo-Qeveritare** me seli në Komunën e Pejës, që veprojnë në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Kriteret për aplikantët:

Të jenë të regjistruara si OJQ sipas legjislacionit në fuqi.

Të mos kenë përfituar subvencione nga departamentet e tjera të Komunës së Pejës për këtë vit.

Të mos kenë obligime tatimore të papaguara.

Të kenë përmbyllur raportet financiare dhe narrative të projekteve të vitit të kaluar.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

Formulari i aplikacionit për projekt.

Formulari i propozim-buxhetit.

Formulari i deklaratës së partneritetit (nëse aplikohet në bashkëpunim me një organizatë tjetër).

Certifikata e regjistrimit dhe certifikata e numrit fiskal.

Vërtetimi që nuk ka obligime tatimore (të lëshuar nga ATK).

Konfirmimi mbi llogarinë bankare të lëshuar nga banka.

Aplikimi:

Propozimet duhet të dorëzohen në sportelet e Komunës.

Afati për aplikim: **03 Shkurt – 03 Mars 2025**

Formularët e nevojshme për aplikim mund t'i gjeni në këtë link:

<https://shorturl.at/8r7E2>